



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIOIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlažna

Nr. -1-70
Br.

OBILIO-OPŠTINA

Data 19.06.2020
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:


Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.26.06.2020, (e premtë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për ndërrimin e kulturës në parcelën Nr.P-72614055-01842-8
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për fillimin e procedurës për aktin e themelimit të Bibliotekës komunale (Biblioteka e Qytetit)
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjoheje dhe Falenderimeve në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së Komandantit të Policisë, të stacionit në Obiliq
7. Shqyrtimi i KAB-it, për periudhën 2021-2023
8. Shqyrtimi i kërkesës së DAP-së, për lirimin e ngastrës Nr.01842-1, Z.K.Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit


Burim Gërguri



Dalës-Izazna
Nr. 1-69
Br.

Data 19.06.2020
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt. 27.05.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Qendresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjera: Arben Berisha, drejtore i DPUKP-së, Vlora Mjekiqi Kabashi, drejtoreshë e DSHMS-së, Valmir Sadiku, përf.i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalitnga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar i DEFZH-së
4. Shqyrtimi i Raportit të DSHMS-së, menaxhimi i situatës me pandeminë (Covid 2019)
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2019
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – Fillimisht i ftoi të pranishmit për 1 minutë heshtje me rastin e viktimate të situates së pandemisë Covid 2019.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzerit nga të pranishmit,

1. Pika e parë e rendittëdhitës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

2. Pika e dytë e rendit të ditës

Aprovohet njëzerit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Pika e tretë e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju e keni pranu Raportin 3 mujor financiar të DEFZH-së dhe nëse, nuk kemi diskutime atëherë e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin 3 mujorfinanciar të DEFZH-së.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më detal rrëth menaxhimit të situatës me pandeminë (Covid 2019), fjalën ia dha drejtoreshës së DSHMS-së.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Pas qfaqjes së corona virusit si pandemic globale Komuna e Obiliqit ka ndërmarrë masat adekuate nga Qeveria e Kosovës. Raporti i Drejtorisë tonë për menaxhimin e situates së pandemisë është një raport përbajtësor që përbën aktivitete të realzuara në mënyrën më të mire të mundshme për arritjen e një situate të qetë dhe stabile. Raporti vazhdon akoma të plotësohet me aktivitete shtesë sepse lufta ndaj corona virusit nuk përfundon sot, por ajo vazhdon deri në përfundimin e pandemisë globale. Një falenderim i veçantë i shkon personelit shëndetësor dhe donatorëve vendor të cilët kontribuan në vazhdimesi, kështu që ne kemi arritë ti ndajmë 4200 pakos për familjet në nevojë

Kryesuesi – Unë i falenderoj donatorët e brendshëm dhe të jashtëm për ndihmën e dhënë në kohën e pandemisë për Komunën tonë. Poashtu, ne kemi mbajtë edhe mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal me ç'rast kemi ndarë 100,000 €, por mbi të gjitha si Drejtori ju falenderoj për punën dh engazhimin që keni pasë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin e DSHMS-së, menaxhimi i situatës me pandeminë (Covid 2019).

Pika e 5 e rendittëditës

Kryesuesi – Fillimisht e falenderoj Ekzekutivin e Komunës, për punën e jashtëzakonshme që e kanë bërë siç shihet një punë voluminoze e dhenë vet në raportin e Kryetarit dhe nëse, nuk kemi diskutime e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtimin e raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për këtë mbledhje nuk kemi kërkesa, por ju njoftoj se nga MAPL-ja, na janë kthyer 2 vendime: vendimi për pagesat sipas kontratës kolektive lidhur me shpërbllimin jubilar për të punësuarit në Arsim dhe vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për transportin e 22 nxënësve në relacionin Mazgit-Shkabaj dhe anasjelltas. Këto vendime i kemi marrë bashkarisht dhe do ti shqyrtojmë në mbledhjen e Kuvendit.

Pika e 7 e rendit të ditës

Linda Sadiku – Edhe pse kryesuesi e përmendi në fillim të mbledhjes, mendoj se edhe ne si Komitet për politikë dhe financa duhet të shqyrtojme çështjen e bizneseve dhe t'u dalim në ndihmë sa më shpejtë këtyre bizneseve. Kjo nga fakti se të gjithë e dijmë se në Komunën tonë edhe para pandemisë edhe gjithëherë të bërit biznes ka qenë e vështirë, ndërsa tani gjendja është edhe më e rëndë dhe rimëkëmbja do të jetë shumëfish më e vështirë. Prandaj, propozoj që të bëhet ndonjë pako stimuluese, psh bizneset të cilat shfrytëzojnë pronat komunale t'i lirojnë nga taksa së paku deri në fund të vtit apo Drejtoritë përkatësse të gjejnë sa më shpejtë ndonjë model apo mënyrë për t'iu ndihmuar sepse ka biznese që nuk mund as të fillojnë me punën shkaku i dëmeve ekonomike që ka shkaktuar kjo pandemi.

Fatmir Bekteshi – Propozoj që bizneset të kenë si masë lehtësuese të paktën në 6 majorin e pare të lironen nga taksa vjetore ata të cilët nuk kanë operue. Poashtu, propozoj edhe sa i përket taksës kmunale të lironen psh ne kemi dhënë edhe tokën në shfrytëzim, objekte në shfrytëzim, prandaj të paktën në 6 majorin e pare të lironen. Ndërsa, kjo çështje për 6 majorin e dytë duhet të shqyrtohet

Arben Berisha – Ju duhet ti keni parasysh se ne s'mund ti lirojmë nga taksat të cilat janë të caktuara nga Qeveria, ndërsa për taksat komunale Kuvendi mund të mere vendim.

Fatmir Bekteshi – Pyeti lidhur me kërkesat që kanë qenë më heret ku kanë mbetë psh kërkesa e Handikos-it.

Kryesuesi – Përgjegjet se të gjitha rekomandimet që ne ua kemi dërguar Dejtorive, ato Drejtori i shqyrtojnë dhe lidhur me kërkesën e Handikosit, ka 3 vite që ne nuk marrimvendim, por në bazë të Rregullores Drejtoria e shëndetësisë bën thirrje publike për aplikim.

Hysni Mjeku – Kërkoi sqarim rrëth rrugës Obiliq-Grabofc, sepse ne në séance të Kuvendit kemi marrë vendim që në pjesën e dytë rruga të kryhet deri në Grabofc


Kryesuesi – Përgjegjet se ju e dini se ka qenë një project në mes të Komunës dhe Ministrisë së infrastrukturës, por kur është bërë planifikimi në vitin 2018 rruga ka qenë 4 ose 5 metra, pastaj është bërë 6 metra. Unë nuk kam informacion më tepër se a do të vazhdoj apo jo, nuk e di dhe nuk është buxhet i këtij viti, por është buxhet i vtit të kaluar. Prandaj, edhe nëse renovohet ajo rugë njëherë gropat duhet të mbyllen mirë, të sanohet pastaj të vendoset një shtresë.

Tani, meqë, na erdhi një kërkesë nga Kryetari po ju njoftoj me kërkesën e tillë për marrëveshje bashkëpunimi dhe financimi në mes të Shoqatës Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit” dhe Komunës tonë.


Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesën e Kryetarit të Komunës për marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Shoqatës Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit” të përfaqësuar nga Berat Kabashi, drejtor i përgjithshëm dhe në mes të Komunës së Obiliqit, të përfaqësuar nga Xhafer Gashi, Kryetari i Komunës së Obiliqit, me qëllim të financimit të projektit për ndërtimin e 20 (njëzet) shtëpi.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50'

Procesmbajtëse


Azize Zeneli




Kryesuesi i KPF-së

Burim Gërguri